



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 218 dt.26.11.1994

MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN TETOR 1994

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën ekonomike dhe Përkujdesin Shoqëror”, V.K.M. Nr.622, dt.31.12.1993 “Për dhënie e ndihmës ekonomike” V.K.M. Nr.311, dt.11.07.1994, “Për përfitimin e paaftësisë”, pika.7 dhe Udhëzimi Nr.9, dt.23.02.1994 të Ministrisë së Punës Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.26.11.1994, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore,

VENDOSI

1. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike 46 familje, të cilat nga verifikimi u konstatua se ishin në marrëdhënie pune, kishin makina private, mirëqenie të mirë ekonomike, ishin të larguar jashtë shtetit etj.
Sipas pasqyrës së bashkangjitur.
2. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin tetor 1994 gjithsej 12.910 familje me një fond prej 35.8 milion lekë, nga të cilat :

- 1.Me ndihmë të plotë 12.002 familje me një fond prej 34.6 milion lekë
- 2.Me ndihmë të pjesshme 908 familje me një fond prej 1.2 milion lekë.
E detajuar sipas njësive administrative në pasqyrën e bshkëngjitur vendimit.
3. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar, në masën 1.344 lekë familjet e mëposhtëme :
 - Zenepe Plaka, Nj.A.1
 - Nazmie Tabaku, Nj.A.8
4. Të përfitojnë ndihmë ekonomike si raste të veçanta :
 - Resmie Alimedani, ndihmë e plotë, për 1 anëtarë, Nj.A.1
 - Vojsava Abazi, ndihmë e plotë, për 1 anëtarë, Nj.A.4
 - Asllan Vorbsi, ndihmë e plotë, për 1 anëtarë, Nj.A.8
 - Lulzim Pinari, ndihmë e plotë, për 1 anëtarë, Nj.A.9
 - Milika Ngjela, ndihmë e plotë, për 1 anëtarë, Nj.A.11
5. Nuk miratohet kërkesa e zotit Spiro Kume.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen :
 - Seksioni i Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesit Shoqërore
 - Administratorët shoqëror dhe pagatorët e njësive administrative.

KRYETARI

BESNIK PETRELA